

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Shqipe Qerimi, kryetare e kolegjit, Afrim Shala dhe Ferit Osmani, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bujar Ahmeti, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të akuzuarit F.S., nga ..., për shkak të veprës penale lajmërimi ose kallëzimi i rremë, nga neni 390 paragrafi 4 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Dega në Kaçanik, P.nr.42/2017, i datës 9 mars 2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 12 qershor 2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e papabuar ankesa e të akuzuarit F.S., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Dega në Kaçanik, P.nr.42/2017, i datës 9 mars 2018, VËRTETOHET.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj, Dega në Kaçanik, me aktgjykimin e lartcekur, të akuzuarin F.S., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale lajmërimi ose kallëzimi i rremë, nga neni 390 paragrafi 4 i KPRK dhe të njëjtin e ka dënuar me dënim me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind Euro), të cilin dënim i akuzuari do ta paguajë pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, i njëjti dënim do të zëvendësohet në dënim me burgim, duke llogaritur 20 € (njëzet Euro) për 1 (një) burgim.

Është detyruar i akuzuari F.S., që të paguajë paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 50 € (pesëdhjetë Euro).

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i akuzuari F.S., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit për dënimin, duke i

propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, që ta aprovojë ankesën si të bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe vendim.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtrësën PPA/II.nr.386/2018, të datës 24 prill 2018, ka propozuar që ankesa e të akuzuarit, të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtojë shkresat e lëndës, analizoi aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe ankesën e të akuzuarit F.S., konstatojë se:

- ankesa është e pabazuar.

Në ankesën e të akuzuarit F.S., theksohet se shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiston në atë se në aktgjykimin e ankimuar nuk janë paraqitur faktet vendimtare dhe se ky aktgjykim është bazuar në provë të papranueshme, përkatësisht në deklaratën e dëshmitarit. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike konsiston në faktin se gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike e ka bazuar vetëm në deklaratën e “rojës së sigurimit” dhe në asnjë provë tjetër. Në ankesën e paraqitur, i akuzuari i referohet edhe faktit se kishte qenë disa herë për ta vizituar punishten, ndërsa më datën 22 tetor 2016, aty nuk kishte takuar asnjë roje të ditës dhe menjëherë e kishte kontaktuar rojën e ditës i cili ka qenë aty apo do të duhej të ishte aty E.Q., i cili e kishte njoftuar të akuzuarin se me lejen e kompanisë ishte në një takim. Dëshmitari E.Q., me qëllim të shfajësimit nga papërgjegjësia në mbikëqyrje dhe pasi nuk ka qëndruar fare në vendin e punës, kishte deklaruar në polici se kinse i akuzuari e ka joshur dhe i ka bërë presion që ta pranon se aty kishte elektromotor. Në anën tjetër, nuk qëndron fakti se i akuzuari ka bërë lajmërimin e rremë, siç pretendohet në aktakuzë. Gjykata e shkallës së parë e ka arsyetuar rrethanën rënduese “recidivizëm” dhe të njëjtën nuk e ka arsyetuar me asnjë fakt, andaj edhe një rrethanë e tillë nuk mund të merret si rrethanë rënduese.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet e lartcekura të paraqitura në ankesën e të akuzuarit F.S. për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe për shkak të vendimit për dënimin janë të pabazuara. Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar ka paraqitur të gjitha faktet vendimtare që kanë të bëjnë me veprën penale konkrete, duke dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me këto fakte vendimtare. Gjithashtu, aktgjykimi i ankimuar është bazuar në prova të pranueshme dhe të ligjshme të cilat janë administruara gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor. Përveç këtyre shkeljeve të pretenduara, Gjykata e Apelit e Kosovës, duke e shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të KPP, konstatojë se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban as shkelje tjera esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij e as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë

dhe të plotë gjendjen faktike, andaj, edhe nuk qëndron as pretendimi tjetër ankimor për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Në këtë çështje penale, gjykata e shkallës së parë ka administruar një sërë provash, siç janë: marrjen në pyetje të të dëshmitarëve E.Q. dhe Xh.B., marrjen në pyetje të të akuzuarit F.S., si dhe ka administruar disa prova materiale. Pas vlerësimit dhe analizimit të të gjitha këtyre provave, gjykata e shkallës së parë e ka shpallur fajtor të akuzuarin F.S., ngase, veprimet e tij formojnë të gjitha elementet e veprës penale lajmërimi ose kallëzimi i rremë, nga neni 390 paragrafi 4 të KPRK, kështu, që në këtë drejtim, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, edhe gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, andaj, edhe pretendimet ankimore të të akuzuarit janë të pabazuara. Kjo për faktin se është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe një gjë e tillë është vërtetuar nga provat e lartcekura.

Lidhur me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar edhe gjykata e shkallës së parë, dënimi me gjobë i shqiptuar ndaj të akuzuarit F.S., është dënim i drejtë dhe i ligjshëm. Me rastin e shqiptimit të këtij dënimi, gjykata e shkallës së parë kishte marrë për bazë si rrethanë lehtësuese sjelljen e mirë të të akuzuarit në gjykatë, ndërsa si rrethanë rënduese e kishte marrë për bazë fakti se i akuzuari F.S., ka qenë i dënuar edhe më parë për veprë tjetër penale me aktgjykim të formës së prerë. Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se dënimi me gjobë i shqiptuar ndaj të akuzuarit F.S. është edhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe gjendjen ekonomike të të akuzuarit, me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale; të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në këto që u tha më lartë e në bazë të nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
Departamenti i Përgjithshëm  
PA1.nr.378/2018, Më 12 qershor 2018

Procesmbajtësi,  
Bujar Ahmeti

Anëtarët e kolegjit:  
Afrim Shala

Kryetare e kolegjit,  
Shqipe Qerimi

Ferit Osmani